

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### **“KËRTUSHA” SH.P.K.**

Sot në Tiranë, më datën 20.10.2023, me cilësinë e ortakut themelues të shoqërisë:

**LINDA KËRTUSHA** e bija e Tahsim lindur më 19.09.1985 në Durrës dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal I55919066F;

me cilësinë e Ortakut themelues, hartojnë këtë akt themelim të Shoqërisë tregtare **“KËRTUSHA” SH.P.K.**

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare, nënshkruesit dhe themeluesit e saj marrin përsipër të realizojnë e të respektojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

### THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit", i ndryshuar themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar **“KËRTUSHA” sh.p.k.** (më poshtë në këtë akt e quajtur "Shoqëria") nga Ortaku themelues i saj.

### FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria **“KËRTUSHA” SH.P.K.** më poshtë e referuar si “Shoqëria”, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit nr. 9901, datë

14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej cdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

## **II. EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA**

### **NENI 1**

#### **EMRI**

Emri i shoqërisë është “**KËRTUSHA**” SH.P.K. Në cdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- (i) fjala “me përgjegjësi të kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

### **NENI 2**

#### **SELIA**

Selia administrative e shoqërisë do të jetë në **Rr:”Bajram Curri” Pallati 1 Maj, Shkalla 24, Apartamenti 100, Tiranë.**

### **NENI 3**

#### **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **III OBJEKTI I SHOQËRISË**

### **NENI 4**

#### **OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

1. *Veprimtari e agjentit për transfertë parash në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo banke;*



2. *Veprimtari e agjentiti për arkëtimet e pagesave për të tretë në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo banke;*
3. *Veprimtari e agjentit komisioner;*
4. *Shërbimet UnionNET - Western Union.*

Përvec veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë cdo veprimtari që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

#### **IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI**

##### **NENI 5**

##### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1kuotë me një vlerë nominale si më poshtë:

**ZNJ.LINDA KËRTUSHA - 1 KUOTË ME VLERË 100.000 LEKË**

**OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:**

**ZNJ.LINDA KËRTUSHA - 100%**

##### **NENI6**

##### **ORGANIZIMI**

Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Këtë detyrë do ta kryej për një periudhë prej 5(pesë) vitesh, **Znj.Linda Kërtusha**, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.

**ORTAKU I SHOQËRISË**

**“KËRTUSHA” SH.P.K**

**LINDA KËRTUSHA**

Linda Kërtusha